

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Mr. Bahri Koskoviku

**SINTAGMAT PARAFJALORE NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2019

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”

Faculty of Philology

Mr. Bahri Koskoviku

# **Prepositional Phrases in Albanian Language**

Doctoral thesis

Prishtinë, 2019

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Mr. Bahri Koskoviku

**SINTAGMAT PARAFJALORE NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. asoc.dr. Linditë Rugova

Bashkëmentori: Prof.asoc.dr. Giuseppina Turano

Prishtinë, 2019

## Rezyme

Struktura e punimit të disertacionit të doktoratës “ Sintagmat parafjalore në gjuhën shqipe” përbëhet nga dymbëdhjetë krerë:

Në kreun e parë përshkruhet baza teorike e punimit të disertacioni të doktoratës që mbështetet në parimet e gramatikës gjenerative. Përgjithësisht argumentohet se përvetësimi i gjuhës është një proces me bazë biologjike. Sipas këtij koncepti qeniet njerëzore kanë një mekanizëm të lindur në trurin e tyre që quhet kompetencë që aktivizohet nga ambienti shoqëror, e manifestuar nga situatat konkrete aktuale e njohur si performancë. Brenda këtij kreu trajtohen edhe modulet teorike të gramatikës gjenerative, si: teoria e lidhjes dhe e drejtimit, teoria e rasës, teoria e roleve tematike, teoria e kontrollit dhe teoria e kufizimit, të cilat veprojnë në intereaksion për t'u dhënë shpjegim shumë operacioneve në strukturën e fjalisë brenda skemës X-bar.

Në kreun e dytë jepet një historik i koncepteve tradicionale, bazuar në teorinë e togfjalëshit, ku parafjalët trajtohen si elemente që nuk mund të formojnë një gjymtyrë fjalie, për shkak se nuk janë fjalë autonome në strukturën e fjalisë dhe analiza në përbërës të drejtpërdrejtë, e cila i përkufizon parafjalët si kategori drejtuese që formojnë një sintagmë funksionale.

Në kreun e tretë tërhiqet një vijë e qartë dallimi midis komplementëve dhe adjunktëve në strukturën e fjalisë. Përgjithësisht qartësohet raporti kokë – komplementë dhe relacioni i një VP me adjunktët.

Në kreun e katërt jepet një vështrim i përgjithshëm për parafjalët mbi bazën e koncepteve dhe teorive të ndryshme, duke filluar nga tradita gramatikore deri te gjuhësia gjenerative si stadi më i avancuar në studimet sintaksore, ku vihet në dukje qasje të ndryshme rreth statusit mjaft të diskutueshëm të parafjalëve.

Në kreun e pestë shtrohet për diskutim problemi bazik në këtë punim disertacioni: përkufizimi i parafjalëve si koka leksikore apo koka funksionale. Studimet gjenerative kanë vërtetuar se përshkrimi i sintagmave parafjalore të shqipes nuk mund të bëhet sipas formulimit tradicional PP-P-NP dhe kategoria P nuk mund të identifikohet vetëm me rasën.

Sipas Greemshaw-it (2005) thelbësore për të përcaktuar natyrën e një kategorie sintaksore janë tiparet sintaktike të saj. Ky është një parim fundamental i gjuhësisë gjenerative. Veçoritë sintaktike argumentojnë se parafjalët kanë strukturë argumentore (zotërojnë tiparin e seleksionimit kategorial), kanë strukturë tematike (zotërojnë tiparin e seleksionimit semantik) dhe kanë një përmbajtje të qartë semantike. Pra parafjalët janë një kokë leksikore X që formojnë një projektion maksimal XP.

Nëse struktura e PP-ve shpjegohet sipas traditës PP-P-NP dhe parafjalët identifikohen me rasën, duke i ekuivalentuar me infleksionin, siç pohon R. Jackendoff parafjalët vërtetë do të ishin semantikisht të zbrazta. Përkufizimi i parafjalëve si koka funksionale ngrit shumë pyetje në një këndvështrim më të gjerë:

- cili është funksioni i kategorisë P kur ato janë para një fjale që nuk është emër;
- nëse parafjalët kanë strukturë tematike ( $\theta$ -marker) dhe kanë përmbajtje përshkruese, atëherë si mund të definohen si kategori ekuivalente me eptimin rasor;
- Nëse kategoria P është një fjalë funksionale që projekton një sintagmë, pse kjo rregull nuk vlen edhe për elementet e tjera funksionale.
- nëse disa tipe parafjalësh janë gjithnjë transitive me tiparin [+ compl], si: *në, nga, mbi, nën, nëpër, pa, për, nën* etj., parë nga koncepti i valencës kjo vlen edhe për kokat leksikore. Një folje kalimtare nuk mund të realizohet si një projektion XP pa i përmbushur valencat e tyre.

Në kapitullin e gjashtë jepet një shpjegim i gjerë rreth konceptit të parafjalëve, të cilat si koka  $X^0$  formojnë një strukturë XP. Sipas interpretimit tonë bazuar në hulumtimin që kemi bërë në gjuhën e letërsisë artistike dhe në gjuhën e portaleve, tipari [- compl] nuk është një tipar absolut, por relativ. Kështu që parafjalët e tilla sipas këtij interpretimi nuk janë parafjalë të mirëfillta intransitive, por parafjalë ergative që kanë aftësinë të realizohen në mënyrë të dyfishtë, si transitive dhe jointransitive.

Në kapitullin e shtatë janë hartuar rregullat për gjenerimin e sintagmave parafjalore të shqipes, ku vërtetohet se domeni i parafjalëve nuk mund të kufizohet vetëm me emrin si domeni prototip i tij, përkundrazi brenda domenit të parafjalëve mund të përfshihen komplementë me status kategorial të ndryshëm, si një AP, ADP, PP, S' etj., kjo determinohet nga tipi i parafjalës.

Fakti se parafjalët përzgjedhin objekte të ndryshme nga aspekti kategorial, flet se parafjalët janë koka leksikore, se tiparet e parafjalëve nuk janë tipare të domenit të tyre [+N] siç pohon Zwarts e Greemshaw apo tipare sintaktike heterogjene [- V, +N]. Tiparet leksikore të kokës P janë ato që përcaktojnë strukturën e kategorisë PP, strukturën e saj tematike dhe natyrën e komplementit që do të përzgjedhë.

Pohimi i gramatikave tradicionale se vetëm fjalët autonome në strukturën e një fjalie përbëjnë një objekt të mirëfilltë sintaksor, (një nga kriteret e S, Abneyt,) nga perspektiva e sotme është i paqëndrueshëm për dy arsye:

E para, raporti i një parafjale me objektin e saj është një raport i drejtpërdrejtë, internal njësoj sikurse i një folje kalimtare me një kundrinor të drejtë. Në këtë kuptim kundërshtojmë pikëpamjet e Emonds-it se parafjalët përpara një NP janë koka funksionale dhe transmetues indirekt i roleve *theta* nëpërmjet një kokë leksikore N, V, A. E dyta, aftësia e PP-ve për t'u gjeneruar në nivelin X, përkatësisht futja e konceptit të parafjalëve intransitive në gjuhësinë moderne, fillimisht nga E.Klima (1965), më pas nga Emonds (1971), R. Jackendoff, Pullum (2002), L. Rugova&B. Rugova (2013) etj., rrëzon një fakt të absolutizuar të gjuhësisë tradicionale se parafjalët, në kuptimin sintaksor, nuk mund të realizohen pa një NP.

Ne votuam *kundër*

Iku *larg*

Vështroi nga *brenda*

Ajo ecte *përpara*

Doli *jashtë*

Në këtë kre do të bëjmë një analizë të strukturës së përbërsve sipas skemës X-Bar, një teori universale për formimin e përbërsve sintaksorë në fjali. Strukturimi i përbërsve sintaksorë në këtë kre bazohet në rregullat e projektimit, ku vlerën e sintagmës X e kanë vetëm kokat leksikore N, V, A, P, AD.

Në kapitullin e nëntë trajtohen sintagmat funksionale të shqipes. Kjo hipotezë, siç pohon Rizzi&Cinque (2016:141), praktikisht e gjeneralizon teorinë X-Bar, duke e bërë konceptin e përgjithshëm të strukturave sintaksore më të thjeshtë dhe më uniform. Vlerën e kategorisë X e

kanë edhe kategoritë funksionale, si komplementuesi C, infleksioni I dhe determinerët D, të cilat formojnë një projektion maksimal CP, IP, DP. Ideja thelbësore e një sintagme funksionale është se një përbërës sintaksor shihet si një zgjerim i një koke leksikore rrethuar nga një kokë funksionale, e cila etiketon strukturën e përbërësit sintaksor.

Në kapitullin e dhjetë përshkruhen funksionet strukturore dhe gramatikore të sintagmave parafjalore të shqipes. Sikundër thotë Chomsky (1985) funksionet komplement, adjunkt, kryefjalë, kundrinë janë kategori relacionale. Në të vërtetë, brenda këtyre relacioneve dallojmë kategoritë strukturore sintaksore: komplement, adjunkt dhe modifikues që shënojnë natyrën e lidhjeve strukturore sintaksore të sintagmave në fjali dhe mbi bazën e këtyre lidhjeve gramatikore përcaktohen edhe funksionet gramatikore të këtyre përbërësve sintaksorë.

Në kapitullin e njëmbëdhjetë trajtohen funksionet semantike të sintagmave parafjalore të shqipes, për të cilat ka një përvojë të konsiderueshme hulumtimi në studimet sintaksore shqipe, duke filluar me A. Xhuvanin, me S. Priftin, me Domin etj. Numri i funksioneve semantike është i mjaft i larmishëm edhe duket se është vështirë të identifikohet numri i saktë i tyre.

Në kapitullin e dymbëdhjetë jepen përfundimet, ku bëhet një prezentim i përgjithshëm i rezultateve të arritura në këtë punim disertacioni.

## Summary

The Doctoral dissertation “Prepositional phrases in Albanian language “consists of twelve chapters:

In the first chapter, the theoretical basis of the doctoral dissertation based on the generative grammar principles is described. In general, it is argued that language acquisition is a biological based process. According to this concept, people have an inborn mechanism in their brains which is called competence. This competence is activated by the social environment which is manifested by actual concrete situations known as performance. Within this chapter, theoretical modules of generative grammar, such as: theories of binding, case, thematic role, control and constraints which operate in interaction to give an explanation to many operations in the sentence structure within the X-bar theory are treated.

The second chapter introduces the history of traditional concepts, based on the traditional account, when prepositions are treated as functional elements that cannot form a phrases, because they depend morphologically on other materials (from a NP) in the sentence structure and in ICA (immediate constituents analysis), which defines prepositions as the governing category that form a functional phrase.

In the third chapter, the different statuses of the various constituents that represent XP projections in sentence structure will be discussed. We will see that some of them are obligatory, while some others are optional. It will be seen that the number and type of arguments depends on the semantic properties of its predicate. In this sense, a clear line of difference between complements and adjuncts in the sentence structure has been drawn.

The fourth chapter gives a general overview of the prepositions on the basis of concepts and theories, starting from the grammatical tradition to generative grammar as the most advanced stage of syntactic studies, pointing out the different approaches about the quite controversial status of prepositions.

In the fifth chapter, the basic problem in this doctoral dissertation such as the definition of prepositions as lexical or functional head is discussed.

Generative studies have proved that the description of Albanian prepositional phrases cannot be done according to the traditional formulation PP-P-NP and the P category cannot be identified by case only. As R. Jackendoff claims if this were the case, prepositions will indeed be dull.

According to Greemshaw (2005), Syntactic features are essential for determining the nature of syntactic category.

This is a fundamental principle of generative grammar. The syntactic features argue that prepositions have an argument structure (possess the category of semantic selection), have a thematic structure (possess the semantic selection property) and have a descriptive content. So prepositions are a terminal strings  $X^0$  that form a maximal XP projection. In other words, PP is a maximal projection of its head  $P^0$ . If the structure of PP is explained according to the PP-P-NP tradition, then many issues remain open:

- What is the function of P category when they are in front of a word that is not a noun.
- If the prepositions have thematic structure ( $\theta$ -marker) and have descriptive content, then how can they be defined as an equivalent category with inflection.
- If P category is a functional word that projects a phrase, why this rule is not applied to other functional elements as well.
- If some type of (transitive) prepositions from the grammatical point of view depends from a NP such as: *in, from, over, under, through, without, for, below*, etc., seen from the concept of valence this also applies to lexical heads. A transitive verb cannot function as an XP category without fulfilling their valence.

In the sixth chapter a broad explanation about intransitive prepositions has been given. According to our interpretation based on a research that we have done using the language of artistic literature and language of portals, the [- compl] feature is not an absolute but relative feature.

According to this interpretation, such prepositions are not pure intransitive prepositions, but ergative prepositions that have the ability to be realized in a dual, transitive and intransitive manner.

In the seventh chapter, the rules for generating prepositional phrases in Albanian language have been given. It is verified that the prepositional domain cannot be limited to the NP as its prototype domain, instead within the prepositional domain, complementary with different categorical status, such as AP, ADP, PP,S' can be included. This is determined by the prepositional type.

The fact that prepositions select different objects from the categorical aspect, suggests that prepositions are lexical heads, that the prepositional features are not a feature of their domain [+N] as claimed by Zwarts and Greemshaw or heterogeneous syntactic features [-V, +N].

Lexical features of the P head are the ones that determine the structure of PP category, its thematic structure and the complement nature which will select.

The assertion of traditional grammars that only autonomous words in the structure of a sentence represent an authentic syntax object, one of S criteria, Abneyt, defines prepositions as a functional heads, since PPs *with friends, without pencil, on the table, for you* etc., according to this concept cannot be realized without a complement. According to us, this assertion from the perspective of today's studies is unstable for two reasons:

The first, the relation of a preposition with its object is a direct, internal relation, just like a transitive verb with a direct object. In this sense we oppose Edmonds's view that prepositions before a NP are functional heads and indirect transmitter of *theta* roles through a lexical head N, V, A. Secondly, the ability of PPs to generate at level X, respectively the introduction of the concept of intransitive prepositions into a modern linguistics, initially by E.Klima (1965), then by Edmonds (1971), R Jackendoff, Pullum (2002), L. Rugova&B. Rugova (2013) etc., overthrows an absolute fact of traditional linguistics that prepositions, in a syntax sense, cannot be realized without a NP.

We voted against

Gone *away*

Looked from the *inside*

She walked *forward*

It came *out*

In this chapter we will make an analysis of the constituents' structure within the framework of the X-bar theory. The structuring of phrases in this chapter is based on the projection rules, where the values of the phrase X has only the N,V,A,P, AD lexical heads.

In the ninth chapter, the Albanian functional phrases have been treated. This hypothesis, as Rizzi&Cinque(2016:141) claim, practically generalizes the X-Bar theory from contentive categories to all categories making the general conception of syntactic structures simpler and more uniform.

The value of X category is also present in the functional categories, such as complementizer C, inflection I<sup>0</sup> and determinants D, which form a maximal projection CP, IP, DP. The essential idea of a functional phrase is that a syntax constituent is seen as an extension of a lexical head surrounded by a functional head, that identifies all the extending projection of the phrase.

In the tenth chapter, the structural and grammatical functions of prepositional phrases of Albanian have been described. As Chomsky (1985) says, subject, complement, adjunct, object are relational categories.

In fact, within these relationships we distinguish the syntactic structural categories: complement, adjuncts and modifiers that mark the nature of structural syntactic connections of phrases in a sentence. On the basis of these grammatical connections, the grammatical functions of these syntactic components are also defined.

In the eleventh chapter, the semantic functions of prepositional phrases of Albanian have been described. There is a considerable research experience in Albanian syntax studies, starting with A. Xhuvani, S. Prifti, Domi and others. The number of semantic functions is quite diverse and their accurate number seems difficult to be identified.

In the twelfth chapter, the conclusions have been given. A general presentation of the results achieved in this dissertation thesis has been presented.

